



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 16.8.2016, ora: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi dhe Shqipe Pantina.

Munguan: Pal Lekaj, Jelena Bontiq, Zafir Berisha dhe Alma Lama.

Në mbledhje mori pjesë edhe Isa Krasniqi, kryeshefi ekzekutiv i ASK-së.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për vitin 2015;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për vitin 2015;

Zenun Pajaziti, ia dha fjalën kryeshefit të ASK-së, Isa Krasniqit, për të paraqitur raportin vjetor.

Isa Krasniqi, kryeshef ekzekutiv i ASK-së, njoftoi komisionin rreth procedimit të raportit vjetor, konform ligjit. Raporti miratohet nga Qeveria dhe pastaj nga Kuvendi.

Ai tha, se ASK-ja funksionon mbi bazën e ndryshimeve ligjore, legjislacionit të BE-së dhe rekomandimeve të Eurostat-it. Gjithashtu aktivitetet e statistikave janë realizuar mbi bazën e mbështetjes financiare nga projektet e BE-së, të cilat janë të cekura edhe në raport.

Xhevahire Izmaku, tha se raporti është i punuar mirë krahasuar nga vitet e mëparshme, dhe pyeti rreth parimit të probabilitetit, besueshmërisë, në kontekstin e mbledhjes së të dhënave, lidhur me përgjegjshmërinë e personave të cilët janë të angazhuar nga ASK-ja për mbledhjen e të dhënave si dhe për statistikën e veçanta dhe çështjet e Eurostat-it.

Shqipe Pantina, theksoi se nuk mund të vlerësohet një raport i mirë, pa u cekur objektivat e institucionit për vitin 2015, si kanë qenë të përcaktuara dhe kush i përcakton objektivat për arsye se mbi bazën e objektivave përcaktohet përmbushja e tyre.

Vërejtja pati edhe në gjuhën e hartimit të raportit, në paqartësinë e shifrave, mungesa e një analize sqaruese për të dhënat e shënuara, mangësitë në pjesën buxhetore të raportit si dhe forma e raportit ashtu siç e kërkon Kuvendi.

Gjithashtu, ajo pyeti se cilat janë rekomandimet dhe kërkesat e ASK-së për Qeverinë dhe Kuvendin, në kuptimin e krijimit të lehtësirave për punën e ASK-së.

Kujtim Paçaku, pyeti sa është rritur bashkëpunimi në mes OJQ-ve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe sa janë të involvuar individë të komuniteteve në fjalë në zyrat e regjistrimit, me qëllim që ata të vëzhgojnë procesin e regjistrimit të komunitetit që i takojnë.

Sadri Ferati, tha se raporti është i hartuar mirë dhe është pozitive që ASK-ja mbështetet nga institucionet ndërkombëtare dhe është në interes të përbashkët që të rriten të dhënat e komunitetit të biznesit.

Zenun Pajaziti, komentoi për statistikën e punësimit, mënyrën e hartimit dhe krahasimin me të dhënat e institucioneve të tjera.

Isa Krasniqi, u përgjigj në pyetjet e anëtarëve të komisionit:

Aspekti i besueshmërisë dhe saktësisë është synim kryesor i të gjitha institucioneve ndërkombëtare, përpunimi i të dhënave bëhet në bazë të metodologjisë dhe standardeve të Eurostat-it.

Sa i përket përmbajtjes së raportit, është bërë përpjekje që të hartohet konform standardeve, ndërsa objektivat janë të caktuara nga përgjegjshmëria ligjore dhe programeve të përcaktuara sipas strategjisë 2013-2017, mbi bazë të të cilave përcaktohen planet vjetore dhe paraprakisht miratohen nga Qeveria.

Konstatim: Komisioni me shumicë votash për dhe një kundër, miratoi Raportin dhe nxori këtë,

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për vitin 2015.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Arsyetimi

Në bazë të nenit 7.2.8 të Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës ia paraqet, përmes Kryeministrit, për miratim Qeverisë dhe Kuvendit raportin mbi zbatimin e planit, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 16.8.2016, shqyrtoi Raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për vitin 2015 dhe vlerësoi se raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 7.2.8 të Ligjit për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Mbledhja përfundoi në orën: 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Zenun Pajaziti